



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.385/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Blerim Grainca kandidat për deputet nga koalicioni LDK-AKR, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

## V E N D I M

- I. **Pranohet** si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Blerim Grainca nga koalicioni LDK-AKR,
- II. **Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni LDK-AKR në Vendvotimin 2532D/01R
- III. **Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.
- IV. **Edison Miftari** me nr. të letërnjoftimit [REDAKTUAR], në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 2532D/01R, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

## A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 30.06.2017 në ora 12:05, nga Blerim Grainca kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se në Vendvotimin në fshatin Tërrn nr.2532D/01R është bërë një gabim në formularin e rezultateve ku votat e kandidatit Blerim Grainca me numër 49 i janë shënuar kandidates me numër 48. Parashtruesi i ankesës thekson se është dëmtuar rreth 31 vota dhe ka ndikuar në rezultatit final andaj kërkon të bëhet rinumrimi dhe votat në këtë vendvotim ose të përmisohet ky gabim.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

#### **ankesa është e bazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 2532D/01R është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidati me nr.49, nga radhët e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Komuna e Ferizajit, ka 31 votë, në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i ankesës i posedon 32 vota të vlefshme.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkritazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit, për pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, sepse Kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par.10 të LZP-së, Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë, ka bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesës i është regjistruar vetëm një votë në FRK, ndonëse pas hetimeve të bëra nga paneli është vërtetuar se i njëjti i posedon 32 vota.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 385/2017 me datën 02.07.2017.



**Kryesuesi i Panelit  
Ymer Hoxha**

***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.